



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 746/ prot.
14

Pogradec, më 11.02, 2022

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. SOTIRAQ MANGËRI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues: *"Për lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit, në territorin e Bashkisë Pogradec".*

Me respekt,



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 3 (Tre)

Nr. i i fletëve A4 të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 4 (Katër) .

Nr. i kopjeve: 5 (Pesë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____ .2022

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË _____ .2022

“PËR

**“PJESMARRJEN E BASHKISË POGRADEC NE SUBJEKTE ME
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E
SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT,
LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pika 5 e nenit 14, shkronjës "gj" të nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligji Nr.8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastrukturës së mbetjeve", bazuar në shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 950 Prot, datë 28.01.2022, "Mbi reformën në Sektorin e Ujësjellës Kanalizime", e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec Nr. 559 Prot, datë 01.02.2022 dhe në relacioni i paraqitur, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI :

I. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, për të negociuar me shoqëritë publike të Ujësjellës Kanalizimeve që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë e lidhjes së marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.



2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë UK Pogradec Sh.a. me 100 % të aksioneve, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin dhe Autorizimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të UK Pogradec Sh.a, për Administratorin e Shoqërisë Aksionare për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

3. Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore mbi Reformën në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë dhe Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

6. U shpall sot më datë __. __. 2022.

K R Y E T A R

Sotiraq MANGËRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot. _____

Pogradec, më _____ 2022

RELACION

PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT

PËR

**“PJESMARRJEN E BASHKISË POGRADEC NE SUBJEKTE ME
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E
SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM,
GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA”**

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe referuar shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 950 Prot, datë 28.01.2022, “Mbi reformën në Sektorin e Ujësjetës Kanalizime”, e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec Nr. 559 Prot, datë 01.02.2022, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbajtje si më poshtë:

1. HYRJE

Referuar shkresës së sipërcituar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë propozon bashkimin e Shoqërive U.K Pogradec dhe U.K Prrenjës, sipas hartës territoriale të studiuar dhe propozuar nga AKUM.

Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizime sh.a, që do të krijohet, do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura urbane, në territorin e hartës fizike të propozuar dhe do të funksionojë mbështetur në Ligjin për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.



Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime sh.a, do të ketë aksionerë në Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën e Ujësjellës Kanalizime dhe Bashkitë respective të cilat do të përfshihen në territorin e hartës së propozuar nga AKUM.

Zotërimi i aksioneve në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime sh.a, për secilin prej Bashkive dhe M.I.E, do të përcaktohet bazuar në procedurat që ndiqen sipas Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në rastin e bashkimit të shoqëriave dhe do të sanksionohen në marrëveshjen specifike që do të nënshkruhet midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive respektive.

2. Baza ligjore:

- Ligji Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"
- Pika 2 e nenit 8, neni 14, shkronja "gj" e nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- Ligji Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".
- Ligji Nr.8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar,
- Ligji Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"
- Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastrukturës së mbetjeve".

2.1 INTERPRETIMI I BAZËS LIGJORE:

Pika 5 e nenit 14 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, parashikon detyrimin ligjor si më poshtë:

Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

Gjithashtu shkronja "gj" e nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, parashikon detyrimin ligjor se Këshilli i Bashkisë: "vendos për krijimin e

institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë”.



3. PROPOZIMI:

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Pogradec:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, për të negociuar me shoqëritë publike të Ujësjellës Kanalizimeve që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë e lidhjes së marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.

2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë UK Pogradec Sh.a me 100 % të aksioneve, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetencë të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin dhe Autorizimin në Asambleshë e Përgjithshme të Aksionareve të UK Pogradec Sh.a, për Administratorin e Shoqërisë Aksionare për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

3. Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore mbi Reformën në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë dhe Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a.

5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

Bashkëngjitur shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 950 Prot, datë 28.01.2022, “Mbi reformën në Sektorin e Ujësjellës Kanalizime”, e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec Nr. 559 Prot, datë 01.02.2022.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi:

JURIST:

Srena Berberi



Pranoi:

DREJTOR DREJTORIE

ERINDA KAMOLLI

Miratoi:

NËNKRYETAR

PASKALINO ZIKO

Konfirmoi:

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI



BASHKIA POGRADEC

NR 859 RDT

DAT 01.02.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 450 Prot.

Tiranë, më 28.01 2022

Lënda: Mbi Reformën në Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve

Z. Ilir XHAKOLLI

BASHKIA POGRADEC

I nderuar Z. Kryetar,

Një nga prioritetet parësore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është Reformimi i Sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve, në përmbushje të vizionit të saj për një sistem të besueshëm mbarëkombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizime, që plotësojnë nevojat e një ekonomie në zhvillim dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Reforma e ndërmarrë nga Qeverisja Qendrore, sikurse jeni njohur në takimet e zhvilluara me Kryetarët e Bashkive, Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të AKUM, ka si synim dhe sfidë ristrukturimin e shoqërive të ujësjetës kanalizimeve, për të përmirësuar dhënie të shërbimeve të ujësjetës, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm përbëjnë një komizë gjithëpërfshirëse, e cila kërkon një qasje sistematike me kapacitete të mjaftueshme dhe që garanton mundësinë për një kthim të sigurt të investimit. Sigurimi i ofrimit të shërbimit me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të



përballueshëm për të gjithë deri në vitin 2030, kërkon investime madhore në infrastrukturën në sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime si dhe ruajtjen e higjenes në çdo nivel.

Referuar performancës së dobët që ka paraqitur sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime, e cila vjen nga performanca e dobët komerciale e kombinuar me nivele të larta të humbjeve të ujit konkretisht:

- Norma e ujit pa të ardhura është shumë e lartë e llogaritur në nivelin 65.5 %,
 - Humbja vjetore e llogaritur për të gjithë sektorin në bazë të bilanceve të fundit të mbyllura nga shoqëritë UK, në nivelin 1 869 373 905 lekë.
 - Borxhe të larta ndaj subjekteve buxhetore dhe jobuxhetore, vetëm për OSHEE debia e pretenduar është 11,915,442,882 lekë principali plus 10,029,355,585 lekë interesa
 - Detyrime të larta për kredi, për të cilat shteti ka dalë garant dhe janë të njohura për tu paguar nga UK kundrejt Ministrisë së Financave, të llogaritura dhe të pasqyruara në bilancet e shoqërive në nivelin e 18,055,812,118 lekë,
 - Kosto të larta direkte dhe të pajustificuara ku vetëm treguesi i efijencës së stafit nga 4.6 që është standardi i përcaktuar për sektorin, aktualisht është 6.
- Duke marrë në konsideratë faktin që Shoqëria e Ujësjetllës Kanalizimeve Pogradec, ku Bashkia që ju përfaqësoni është aksioner i vetëm, ka nevojë për:
 1. Mbështetjen e Autoriteteve Qendrore për përmirësimin dhe administrimin e aseteve të saj.
 2. Përmirësimin e gjendjes së saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e saj të administrimit.
 - Mbështetur në gjetjet dhe rekomandimet nga studimet e kryera nga partnerët ndërkombëtarë që mbështesin Qeverinë Shqiptare, si dhe studimeve kombëtare në kuadër të përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane, rezulton se agregimi i shoqërive me numër të ulët të abonentëve duke krijuar shoqëri të konsoliduara me strukturë të përbashkët përmirëson:
 1. Efijencën ekonomike nëpërmjet ekonomive të shkallës;
 2. Akses në burimet ujore dhe menaxhim të integruar të burimeve ujore;
 3. Performancën e treguesve tregtar të UK;
 4. Profesionalizmin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore;
 5. Ndikimin në mjedis;
 6. Mundësitë për financim dhe rritje të kapitalit;
 - Bazuar në legjislacionin në fuqi, si më poshtë:



1. Në nenin 14 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" ku parashikohet që *"Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta"* ;
2. Në nenin 12 Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura", të ndryshuar;
3. Në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar;
4. Në VKM Nr. 431, datë 11.07.2018 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë propozon bashkimin e Shoqërive UK Pogradec dhe UK Prrrenjas sipas hartës territoriale të studiuar dhe propozuar nga AKUM.

Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a. që do të krijohet, ka si objekt të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura urbane, në territorin e hartës fizike të propozuar, dhe do të funksionojë mbështetur në Ligjin për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a. do të ketë aksionerë Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Bashkitë respektive që përfshihen në territorin e hartës së propozuar nga AKUM.

Zotërimi i aksioneve në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a., për secilën prej Bashkive dhe MIE, do të përcaktohet bazuar në procedurat që ndiqen sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" në rastin e bashkimit të shoqërive dhe do të sanksionohen në marrëveshjen specifike që do të nënshkruhet midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Njërive të Qeverisjes Vendore respektive.

Bashkëpunimi midis Autoritetit Qendror dhe Njërive të Qeverisjes Vendore konsiston në:

1. Mirëkuptimin;
2. Kontributin për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje;
3. Reciprocitetin;
4. Pa çenuar autonominë vendore.



Nga sa më sipër, këshillojmë të merrni autorizim nga Këshilli Bashkiak Pogradec me objekt "lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit, në territorin tuaj administrativ".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM do t'ju asistojnë për çdo paqartësi dhe informacion për mbarëvajtjen sa më të mirë të këtij procesi.

Faleminderit për bashkëpunimin.

MINISTËR
Belinda BAKU
Krye-Ministër
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
TIRANË

559
01.02.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 950 Prot.

Tiranë, më 28.01 2022

Lënda: Mbi Reformën në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve

Z. Ilir XHAKOLLI

BASHKIA POGRADEC

I nderuar Z. Kryetar,

Një nga prioritetet parësore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është Reformimi i Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve, në përmbushje të vizionit të saj për një sistem të besueshëm mbarëkombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizime, që plotësojnë nevojat e një ekonomie në zhvillim dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Reforma e ndërmarrë nga Qeverisja Qendrore, sikurse jeni njohtur në takimet e zhvilluara me Kryetarët e Bashkive, Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të AKUM, ka si synim dhe sfidë ristrukturimin e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, për të përmirësuar dhënie të shërbimeve të ujësjellës, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm përbëjnë një kornizë gjithëpërfshirëse, e cila kërkon një qasje sistematike me kapacitete të mjaftueshme dhe që garanton mundësinë për një kthim të sigurt të investimit. Sigurimi i ofrimit të shërbimit me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të

përballueshëm për të gjithë deri në vitin 2030, kërkon investime madhore në infrastrukturë dhe në sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime si dhe ruajtjen e higjienës në çdo nivel.

Referuar performancës së dobët që ka paraqitur sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime, e cila vjen nga performanca e dobët komerciale e kombinuar me nivele të larta të humbjeve të ujit konkretisht:

- Norma e ujit pa të ardhura është shumë e lartë e llogaritur në nivelin 65.5 %,
 - Humbja vjetore e llogaritur për të gjithë sektorin në bazë të bilanceve të fundit të mbyllura nga shoqëritë UK, në nivelin 1 869 373 905 lekë.
 - Borxhe të larta ndaj subjekteve buxhetore dhe jobuxhetore, vetëm për OSHEE debia e pretenduar është 11,915,442,882 lekë principali plus 10,029,355,585 lekë interesa
 - Detyrime të larta për kredi, për të cilat shteti ka dalë garant dhe janë të njohura për tu paguar nga UK kundrejt Ministrisë së Financave, të llogaritura dhe të pasqyruara në bilancet e shoqërive në nivelin e 18,055,812,118 lekë,
 - Kosto të larta direkte dhe të pajustificuara ku vetëm treguesi i efijencës së stafit nga 4.6 që është standardi i përcaktuar për sektorin, aktualisht është 6.
- Duke marrë në konsideratë faktin që Shoqëria e Ujësjetës Kanalizimeve Pogradec, ku Bashkia që ju përfaqësoni është aksioner i vetëm, ka nevojë për:
 1. Mbështetjen e Autoriteteve Qendrore për përmirësimin dhe administrimin e aseteve të saj,
 2. Përmirësimin e gjendjes së saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e saj të administrimit.
 - Mbështetur në gjetjet dhe rekomandimet nga studimet e kryera nga partnerët ndërkombëtarë që mbështesin Qeverinë Shqiptare, si dhe studimeve kombëtare në kuadër të përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane, rezultoi se agregimi i shoqërive me numër të ulët të abonentëve duke krijuar shoqëri të konsoliduara me strukturë të përbashkët përmirëson:
 1. Efijencën ekonomike nëpërmjet ekonomive të shkallës;
 2. Akses në burimet ujore dhe menaxhim të integruar të burimeve ujore;
 3. Performancën e treguesve tregtar të UK;
 4. Profesionalizmin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore;
 5. Ndikimin në mjedis;
 6. Mundësitë për financim dhe rritje të kapitalit;
 - Bazuar në legjislacionin në fuqi, si më poshtë:

1. Në nenin 14 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" ku parashikohet që *"Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta"* ;
2. Në nenin 12 Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura", të ndryshuar;
3. Në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar;
4. Në VKM Nr. 431, datë 11.07.2018 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë propozon bashkimin e Shoqërive UK Pogradec dhe UK Prenjas sipas hartës territoriale të studiuar dhe propozuar nga AKUM.

Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizimeve sh.a. që do të krijohet, ka si objekt të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura urbane, në territorin e hartës fizike të propozuar, dhe do të funksionojë mbështetur në Ligjin për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizimeve sh.a. do të ketë aksionerë Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Bashkitë respektive që përfshihen në territorin e hartës së propozuar nga AKUM.

Zotërimi i aksioneve në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizimeve sh.a., për secilën prej Bashkive dhe MIF, do të përcaktohet bazuar në procedurat që ndiqen sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" në rastin e bashkimit të shoqërive dhe do të sanksionohen në marrëveshjen specifike që do të nënshkruhet midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Njësive të Qeverisjes Vendore respektive.

Bashkëpunimi midis Autoritetit Qendror dhe Njësive të Qeverisjes Vendore konsiston në:

1. Mirëkuptimin;
2. Kontributin për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje;
3. Reciprocitetin;
4. Pa cënuar autonominë vendore.

Nga sa më sipër, këshillojmë të merri autorizim nga Këshilli Bashkiak Pogradec me objekt "lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit, në territorin tuaj administrativ".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM do t'ju asistojnë për çdo paqartësi dhe informacion për mbarëvajtjen sa më të mirë të këtij procesi.

Faleminderit për bashkëpunimin.

MINISTËR

Belinda BALLUKU